

VENDIM
Nr.524, datë 11.12.1992

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTPROGRAMIT PËR BASHKËPUNIMIN
KULTUROR, ARSIMOR E SHKENCOR ME BULLGARINË**

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të "Projektprogramit për bashkëpunimin kulturor, arsimor e shkencor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për vitet 1993-1994".

2. "T'i propozohet palës bullgare për t'u përfshirë në projektprogram shtesat e mëposhtme:

a) Meqenëse viti 1992 po mbyllet, afati i vlefshmërisë së programit të jetë 1993-1994 dhe jo 1992-1994.

b) Fundi i nenit 8 të shprehet: "Instituteve të Studimeve Pedagogjike dhe shtëpive botuese të librit shkollor të niveleve të ndryshme".

c) Neni 9 të formulohet: "Të dyja palët do të mbështetin shkëmbimet e specialistëve të arsimit për të kryer kërkime të përbashkëta në fushën e mesimdhënies dhe të hulumtimit shkencor".

ç) Neni 10 të formulohet: "Të dyja palët do të realizojnë këmbime specialistësh për problemet e organizimit, të administrimit dhe të legjislacionit të shkollave të larta".

d) Neni 11 të formulohet: "Të dyja palët do të nxitin bashkëpunimin për problemet në fushën e arsimit parashkollor".

dh) Neni 12 të formulohet: "Të dyja palët do të nxitin bashkëpunimin në fushën e edukimit të fëmijëve, qoftë edhe jashtë procesit mësimor".

e) Neni 16 të formulohet: "Të dyja palët do të mbështetin bashkëpunimin në fushën e teatrit e të muzikës, të cirkut e të varietesë".

ë) Neni 17 të formulohet: "Të dyja palët do të nxitin vendosjen dhe zhvillimin e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet teatrove dramatike e muzikore dhe asambleve, si dhe ndërmjet krijuesve në fushën e teatrit e të muzikës. Të dyja palët do të shkëmbejnë specialistë, si instrumentistë, balerinë, solistë, regjisor filmi e teatri, akrobatë, aktorë, skenaristë e operatorë filmi, koreografë etj."

f) Neni 18 të formulohet: "Të dyja palët marrin përsipër të shkëmbejnë delegacione në veprimtari kombëtare e ndërkombëtare të teatrit, filmit, muzikës dhe arteve figurative që do të zhvillohen në vendet përkatëse. Gjithashtu do të shkëmbejnë grupe të ftuarish prej 2-3 vetash për në veprimtaritë e zakonshme filmike, e teatrale, muzikore etj."

g) Neni 19 të formulohet: "Të dyja palët, gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij programi, do të organizojnë në kryeqytet e tyre veprimtarinë "Jave kulturore" për secilin vend. Për kohën dhe hollësitë e tjera të organizimit të këtyre eveprimtarive palët do të merren vesh në rrugë diplomatike.

gj) Neni 25 të formulohet: "Palët kontraktuese do të krijojnë lidhje bashkëpunimi të drejtpërdrejta ndërmjet ministrive të Kulturës të të dy vendeve".

h) Neni 26 të formulohet: "Pala bullgare do të shikojë mundësinë për specializime e kualifikime të artistëve dhe specialistëve të artit e të kulturës shqiptare në Bullgari".

i) Neni 27 të formulohet: "Pala bullgare do të shikojë mundësinë e ndihmës teknologjike e teknike dhe me bazë materiale për institucionet artistike shqiptare".

j) Neni 32 të formulohet: "Të dyja palët do të organizojnë gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij programi, javët e filmit shqiptar e bullgar përkatësisht në Sofje dhe në Tiranë".

k) Neni 35 të formulohet: "Të dyja palët do të mbështetin zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të krijuesve dhe shoqatave të artistëve të të dy vendeve. Hollësitë dhe forma e këtyre shkëmbimeve do të vendosen drejtpërdrejt ndërmjet organizatave dhe shoqatave të të dy vendeve".

l) Neni 38 të formulohet: "Të dyja palët do të shkëmbejnë mendime për organizimin e festivaleve ballkanike të teatrove, filmit, operas dhe asambleve".

ll) Neni 39 të formulohet: "Të dyja palët të mbështetin bashkëpunimin në fushën e rinisë dhe për këtë qëllim marrin përsipër të hartojnë një marrëveshje të drejtpërdrejtë në shkallë ministri".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi